

VENDIM
Nr. 145, datë 11.3.2022

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË SHIJAK, KAMZË,
KAVAJË DHE KRUIJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 1 662 442 555 (një miliard e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e katërqind e dyzet e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara në bashkitë Shijak, Kamzë, Kavajë e Krujë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Për Bashkinë Shijak, në masën 107 863 248 (njëqind e shtatë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind e dyzet e tetë) lekë;

b) Për Bashkinë Kamzë, në masën 23 600 000 (njëzet e tre milionë e gjashtëqind mijë) lekë;

c) Për Bashkinë Kavajë, në masën 52 958 153 (pesëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë;

ç) Për Bashkinë Krujë, në masën 1 478 021 154 (një miliard e katërqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e njëzet e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër) lekë.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga bashkitë Shijak, Kamzë, Kavajë dhe Krujë, në masën 997 465 533 (nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e tre) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Shijak i transferohet fondi, në masën 64 717 949 (gjashtëdhjetë e katër milionë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e nëntë) lekë;

b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi, në masën 14 160 000 (katërmëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë;

c) Bashkisë Kavajë i transferohet fondi, në masën 31 774 892 (tridhjetë e një milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë;

ç) Bashkisë Krujë i transferohet fondi, në masën 886 812 692 (tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë.

3. Efekti financiar, për vitin 2022, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet bashkive Shijak, Kamzë, Kavajë dhe Krujë në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Shijak, Kamzë, Kavajë dhe Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj